



PROCESVERBAL

Mbledhja e Komitetit për Arsim e mbajtur me datë **14.10.2022 (E premte)** me fillim në ora **10:00**.

Mbledhjen e dytë e kryesoi kryesuesja **Fahrije Lushi Morina**.

Kryesuesja- Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, besoj që të gjithë me kohë e keni pranuar emalin për mbledhje të komitetit për arsim. Kjo është mbledhja e dytë e komitetit për arsim për këtë vit, si rend dite kemi;

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite;

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Përpilimi i listës së shkollave;
3. Të ndryshme;

Kryesuesja –E qes në votim rendin ditës, me shumicë unanime aprovohet rendi i ditës.

1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesja – A ka dikush ndonjë vërejtje rreth procesverbalit?... Nëse jo, atëherë e vendosim në votim, unanimisht aprovohet pika e parë e rendit të ditës.

2. Përpilimi i listës së shkollave;

Kryesuesja – E hapim diskutimin rreth pikës së dytë, duke bërë përzgjedhjen e shkollave.

Alban Bajraktari - Përshëndetje kolegë/e, stafin këtu që është. Meqë ne si planifikim e kemi vizitën nëpër shkolla me qëllim të hulumtimit dhe evidentimit të gjërave që duhet përmirësuar ose ndryshuar. Para se t'i japim propozimet për vizita në shkolla, duhet t'a kemi parasysh se çfarëdo vizite që bëhet duhet t'a kemi një balancë në mes shkollave të mesme dhe atyre fillore, brenda listës mos t'i anashkalojmë as njërën as tjetrën. Kështu që në bashkëpunim me juve duhet të vendosim në cilat zona dëshirojmë t'i vizitojmë p.sh zonën Rahovec – Krushë, Rahovecin si qytet, zonën e bjeshkës që është Drenoc – Çifllak dhe pjesa prej Ratkoc – Kramovik. Personalisht kisha propozuar që ciklin e vizitave t'ia fillojmë në Rahovec shkollën “Bekim Sylka” në qytet. Çdo propozim që japim le të jetë prej një zone të caktuar, sepse nuk kemi mundësi t'i vizitojmë 29 shkolla, por le t'i prekim të gjitha zonat me nga një vizitë. **Xhevdet Morina** - Përshëndetje për kryesuesen e komitetit për arsim dhe për të gjithë të pranishmit. Unë pajtohem me propozimin e Albanit. Si propozim për zonën tonë nga vij unë për vizitë propozoj t'a vizitojmë shkollën e mesme “12 Maji” në Ratkoc.

Kryesuesja – Të nderuar anëtarë, unë mendoj që janë zona të veçanta dhe e plotësojnë vizitën tonë që do t'a bëjmë në këto shkolla. Unë si propozim kam të vizitojmë shkollën fillore “Isa Boletini” në Rahovec sepse është një shkollë me shumë nxënës, poashtu edhe shkollën e fshatit Opterushë, shkollën fillore në Krushë, shkollën e mesme “12 Maji” në Ratkoc dhe besoj që me këto shkolla mjafton që t'i realizojmë këto vizita në bashkëpunim me DKA-në e cila është zotuar që do të na ndihmojë në këtë proces që veç kemi filluar t'a realizojmë.

Alban Bajraktari – Pajtohem plotësisht me ty. Kemi patur kontakte të vazhdueshme me DKA-në dhe kemi marrë një mbështetje të fuqishme prej drejtorit të DKA-së z. Avni Morina, i cili tha që nuk do të kursehet për asgjë sa i përket realizimit të këtij projekti. Unë nuk jam shumë në dijeni në Rahovec se cilat shkolla kanë nxënës të të gjitha komuniteteve, kjo kishte me i dhënë më shumë vlerë vizitave dhe projektit

tonë. Atëherë kisha propozuar që shkolla "Gëzim Hamza" të jetë pjesë e realizimit të vizitave tona. Poashtu kisha propozuar që listës t'i shtohet edhe shkolla e Kramovikut.

Kryesuesja – Atëherë mendoj se me të gjitha këto propozime do të jetë një vizitë dhe punë e përkryer me kontribut të veçantë që t'i mësojmë vështirësitë që hasin nxënësit gjatë nxënies së mësimi, sa janë praktike pajisjet e shkollave, raportet mësimdhënës – nxënës, metodat e punës etj... Mendoj që duhet t'a shtojmë në listë edhe një shkollë, besoj që pajtoheni që të jetë shkolla fillore në Xërxë.

Alban Bajraktari – Personalisht pajtohem, aq më shumë – aq më mirë. Kemi kërkuar nga DKA-ja që të na pajis me një leje të veçantë që na të kemi të drejtë t'i bëjmë lirshëm këto vizita nëpër shkolla me leje të DKA-së që është institucioni më i lartë i arsimit në komunën tonë. Përveç temave të cekura, ka shkolla që përballen me vështirësi të vijueshmërisë së nxënësve, kur nxënësat me apo pa përkrahjen e prindërve mungojnë në proces mësimor. Le të jetë edhe kjo një pikë hulumtimi se është një problem goxha shqetësues.

Xhevdet Morina – Nëse ka mundësi të definohet vizita në Krushë të jetë shkolla fillore apo e mesme?... Me dëshirën time do t'a vizitonim shkollën fillore.

Alban Bajraktari – Duke marrë parasysh listën e përpiluar kemi një numër të madh të shkollave fillore, e mesmja do t'a bënte një balancim të vizitave.

Kryesuesja – Meqë u diskutua shkolla e Krushës dhe unë si kryesuese propozova shkollën fillore, e vendosim në votim?... Kush është për vizitë për shkollën e mesme?... Atëherë unanimisht është vendosur të vizitojmë shkollën e mesme në fshatin Krushë.

3. Të ndryshme;

Xhevdet Morina – Faleminderit kryesuese. Janë ngritur dy çështje gjatë vizitave që do t'i bëjmë në shkolla të ndryshme në komunë së Rahovecit dhe Albani e ngriti çështjen e mungesës së nxënësve që është një faktor shumë i rëndësishëm në zhvillimin e procesit edukativo – arsimor në shkolla, kështu që edhe unë jam i pajtimit që kjo çështje të ngritet dhe të bëhet në formë hulumtimi; T'i mësojmë shkaqet dhe pasojat e tyre, masat që duhet të ndërmerren nga institucionet vendimmarrëse si dhe ndikimi i familjes në reduktimin e mungesave. Është me rëndësi ta zbulojmë ndikimin e këtyre faktorëve në përmirësimin e vijueshmërisë. Bazuar në këtë fakt, ne si grup do të bëjmë një studim duke i nxjerrë përgjigjet e këtyre pyetjeve; Sa shpesh nxënësit mungojnë në orët e mësimi? Cilat janë arsyet e mungesave? Sa është e lartë shkalla e ikjes prej orëve të mësimi? Sa është e lartë shkalla e përjashtimit të nxënësve nga mësimi? Cilat janë pasojat nga mungesat? Cilat janë masat që ndërmerr shkolla ndaj nxënësve që bëjnë shumë mungesa? Çfarë është komunikimi dhe bashkëbisedimi shkollë – prind?...Këtu është paraparë që më pastaj të marrim përgjigje prej drejtorëve dhe mësimdhënësve të shkollave përkatëse.

Kryesuesja – Faleminderit drejtor. Mendoj që listën që e lexove është mjaftë e qëlluar dhe i përgjigjet secilës arsye të vizitave tona nëpër shkolla, pajtohem unanimisht. Në fund, duke u nisur për faktin që unë kam qenë edhe në mandatin e kaluar këshilltare në kuvendin komunal dhe DKA çdo herë ka bërë raporte rreth problemit të vijueshmërisë së nxënësve në shkolla. Si problematikë tjetër që është duke e shoqëruar vendin tonë është edhe mospjesëmarrja e komunitetit RAE në procese mësimore dhe mendoj që duhet të kemi parasysh të merremi më tepër me këtë çështje dhe duhet të jemi në dijeni se cilat janë arsyet që ky komunitet nuk vijon mësimin. Çështje tjetër është rënia e numrit të nxënësve. Realizimi i orëve nga mësimdhënësit me më pak se 10 nxënës dhe shumë problematika tjera që do të shtjellohen gjatë vizitave tona në shkolla. Nëse nuk ka dikush tjetër diçka, për sot e mbyllim mbledhjen, shihemi herën tjetër.

Mbledhja ka përfunduar në ora: 10:35

Procesmbajtësi;


Arben Krasniqi

Kryesuesi i mbledhjes;


Fahrrie Lushi Morina